


GJL.Nr.995/2012

DPK/DMP

03

03-379/12

23.10.2012



GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Dalip Bega dhe Mejreme Zekaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e sek.juridike Zymrije Çunaku, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Besim Tahiri nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.24126/2012 të dt. 01.08.2012, në bazë të nenit 39, al.3, dhe 221 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 25.09.2012, mori

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është pjesërisht e bazuar.

NDRYSHOHET aktvendimi i goditur ashtu që i pandehuri Besim Tahiri për kundërvajtjen e kryer nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar sipas nenit 17 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, dënohet me gjobë në shumë prej 1000 Euro.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktvendimi e në të kundërtën do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.24126/2012 të dt. 01.08.2012, ka shpall përgjegjës të pandehurin Besim Tahiri nga Prishtina, sepse si zyrtar i lartë publik në pozitë në Sekretariatit e Zyrës në Prokurorinë e shtetit, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë në Agjencioni kundër korrupsionit, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2012, me ç,veprim ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, për të cilën kundërvajtje të pandehurit i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 1500 Euro. Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 5 Euro.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Besim Tahiri, ka paraqitur ankesë për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të drejtës materiale dhe vendimit mbi dënimin ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e anekses. Thëkson se vonesa prej 3 ditësh është vonesë për shkaqe objektive, jo e qëllimshme dhe e justifikueshme duke pasur parasysh shkuarjen time dy herë për të dorëzuar formularin dhe në pamundësi të pritjes gjatë ter dites për shkak të punëve zyrtare dhe volumit të punëve dhe përgjegjësisë, kërkon të merret si masë lehtësuese dhe si veprim i arsyeshëm dhe objektiv por në asnjë rast qëllimi nuk ka qenë mos deklarimi i pasurisë. Më tej thekson se gjopa e shqiptuar është në disproporcion të lartë me pagën e ulët mujore dhe gjendjen jo të mirë ekonomike andaj ka propozuar që aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje ose të ndryshohet e ai të lirohet nga përgjegjësia dhe dënimi i shqiptuar.

2,

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi thëniet në aneksen e paraqitur, aktvendimin e goditur, deklarin e dhënë të pandehurit në seancën shqyrtimit kryesor pranë gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt.02.08.2012, i cili e ka pranuar kundërvajtjen që i vihet në barrë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, andaj ka gjetur se:

Ankesa e paraqitur është pjesërisht e bazuar.


Kolegji vlerëson se gjendja faktike në këtë çështje kundërvajtëse nuk është kontestuese, se i pandehuri ka kryer veprën kundërvajtëse siç është përshkruar në dispozitivin e aktvendimit të goditur, për çka e ngarkon kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse, meqë i pandehuri e ka pranuar në tërësi dhe kjo kundërvajtje e cila i vihet në barrë, dhe mbanë përgjegjësi kundërvajtëse, e cila të pandehurit i ngarkohet se nuk ka dërguar formularin për deklarin e pasurisë brenda fatit ligjor prej 01.03.2012 deri me 31.03.2012.

Kolegji i Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare konformë nenit 219 të Ligjit mbi kundërvajtjet, gjeti se aktvendimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as aplikim të gabuar të drejtës materiale.

Duke vlerësuar aktvendimin mbi dënimin dhe pretendimet ankimore se dënimi me gjobë në shumë prej 1500 Euro është dënim i ashpër, për arsye se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, nuk i ka vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, Kolegji i Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje gjeti se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Andaj sipas vlerësimit të këtij Kolegji të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje, dënimi me gjobë në shumë prej 1500 Euro, është i ashpër duke pas parasysh rrethanat lehtësuese të cilat i ka gjetur gjykata e shkallës së parë me procesverbal të marrjes në pyetje të pandehurit dhe me prova të tjera në shkresat e lëndës, dhe atë se i pandehuri më parë nuk ka qenë e dënuar, se nuk zhvillohet procedurë tjetër kundërvajtëse, se ka përmbushë obligimin ligjor për deklarin të pasurisë në Agjencionin antikorupsion pas disa ditëve, gjendjen ekonomike dhe familjare të pandehurit, ndërsa rrethana renduese gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur, rrethanat të cilat i aprovon edhe Kolegji i Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje dhe gjen se gjykata e shkallës së parë më rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, këto rrethana nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ashtu që Kolegji i kësaj gjykate gjen se këto rrethana lehtësuese e justifikojnë shqiptimin e një dënimi më të butë, dhe duke aprovuar ankesën, e ndryshoi aktvendimin sa i përket vendimit mbi dënimin dhe të pandehurin Besim Tahiri, për veprën kundërvajtëse për të cilën është shpallur përgjegjëse i shqiptoi dënimin me gjobë në të holla në shumë prej 1000 Euro, duke gjetur se ky dënim është adekuat me shkallën e përgjegjësisë, veprën e kryer dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra dhe se me këtë gjobë ndaj tij do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i sanksionimit kundërvajtës dhe se dënimi do të ndikojë te kryesi dhe të gjithë të tjerët që në të ardhme të mos kryejnë kundërvajtje të këtilla dhe të ngjashme.

03-3791/12/03
fugj



3.

Nga se u tha më lartë e në bazë të nenit 221 të LK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
GJL.Nr.995/2012 të dt.25.09.2012

SEK.JURIDIKE,
Zyrtarje Çunaku



KRYETARI I KOLEGJIT,
Ramiz Kuqi